LIGJ
Nr.7574. datë 24.6.1992

PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË DHE DISA NDRYSHIME NË KODET E PROCEDURAVE PENALE E CIVILE

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 24.9.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Gjykata e rrethit është hallka themelore e sistemit gjyqësor. Ajo përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët.

Neni 2

Gjykatat e apelit funksionojnë në zona të caktuara nga Presidenti i Republikës me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ato përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetarët, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët.

Gjykatat e apelit shqyrtojnë ankimet dhe protestat kundër vendimeve penale e civile të gjykatave të shkallës së parë. Ato gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë ose me një gjyqtar sipas kritereve të caktuara në nenin 116 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nenin 63 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 3

Gjykata e apelit shqyrton ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë.

Me kërkesën e palëve ose dhe kryesisht gjykata e apelit përsërit tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqsor të shkallës së parë, duke respektuar rregullat e caktuara në Kodin e Procedurës Penale e Civile. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit të shkallës së parë dhe ato të marra në hetimin paraprak.

Neni 4

Gjykata e apelit pasi administron provat e çështjes vendos lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kur çështja shqyrtohet me protestën e prokurorit dhe del që duhet të bëhet ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës, i cili sjell rëndimin e pozitës së të pandehurit ose kur del nevoja që i pandehuri të akuzohet edhe për një vepër penale tjetër, gjykata e apelit vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes prokurorit.

Neni 5

Gjykatat ushtarake të shkallës së parë gjykojnë ushtarakët për vepra penale ushtarake, robërit e luftës dhe persona të tjerë të caktuar me ligj. Ato përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetarët, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët.

Gjykata ushtarake e apelit gjykon në shkallë të dytë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështje penale të gjykuar nga gjykatat ushtarake. Ajo përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe gjyqtarët.

Neni 6

Kufijtë tokësorë të veprimtarisë së gjykatave, kur ndryshojnë nga ndarja administrative tokësore, caktohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë.

Neni 7

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe ndihmësgjyqtarëve të të gjitha hallkave gjyqësore caktohet nga Presidenti i Republikës me propozim të ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

Gjykata e Kasacionit gjykon në shkallë të dytë vetëm ankesat për dënimet me vdekje. Në këto raste ajo zbaton rregullat e caktuara për gjykatën e apelit.

Neni 9

Gjykata e Kasacionit shqyrton bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugën e ankimit nga palët ose me kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ankimi ose kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të bëhen vetëm për këto shkaqe:

a) Kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji.

b) Kur ka shkelje të rënda të normave proceduriale (neni 171, pragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 173, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale).

c) Kur nuk është marrë një provë vendimtare e kërkuar nga palët gjatë gjykimit.

d) Kur arsyetimi i vendimit është haptazi jo logjikë.

Kundërshtimi në Gjykatën e Kasacionit mund të bëhet brenda një muaji nga dita e dhënies së vendimit të formës së prerë.

Neni 10

Ministri i Drejtësisë në raste të veçanta mund të ngarkojë një gjyqtar të gjykatës së rrethit ose të gjykatave ushtarake për të gjykuar në një gjykatë tjetër rrethi apo ushtarake.

Neni 11

Prokuroria e ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet prokurorëve të caktuar pranë çdo hallke gjyqësore.

Neni 12

Prokuroria drejton e kontrollon hetimin. Ajo fillon çështjen penale, miraton aktet hetimore që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, kryen vetëveprime hetimore kur e çmon të domosdoshme, shfuqizon aktet e paligjshme hetimore, vendos për mënyrën e përfundimit të çështjes hetimore, nëpërmjet pushimit, pezullimit ose dërgimit të saj në gjyq duke miratuar aktet përkatëse ose duke i bërë ato vetë.

Kur hetuesi nuk është i një mendimi me prokurorin, vë në dijeni prokurorin më të lartë, vendimi i të cilit është i detyrueshëm.

Neni 13

Hetimi i veprave penale kryhet nga hetuesia dhe policia hetimore, sipas rregullave të caktuara me ligj. Oficerët e policisë të ngarkuar për hetime caktohen dhe largohen nga kjo detyrë me miratimin e Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Drejtësisë pasi merret edhe mendimi i Prokurorit të

Përgjithshëm.

Neni 14

Kompetenca e hetimit caktohet në çdo rast nga Prokurori i vendit ku ka ndodhur vepra penale.

Për veprat penale të dukshme (me vendngjarje) organet e policisë, njoftojnë prokurorin, mbledhin dhe ruajnë gjurmët, provat, kryejnë veprimet e tjera hetimore që nuk mund të shtyhen, ndalojnë personat që dyshohen për kryerjen e veprës penale dhe brenda dy ditëve çështjen ia dërgojnë Prokurorit bashkë me një relacion. Pas kësaj prokurori vendos për fillimin e çështjes dhe për faktin nëse hetimet do të vazhdojnë nga policia apo çështja do t'i kalojë hetuesisë për ta përfunduar atë.

Kur ngarkohen për vazhdimin e hetimeve, organet e policisëe zbatojnë regullat e caktuara në Kodin e Procedurës Penale për hetuesin, duke kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme, me përjashtim të marrjes së personit si i pandehur dhe të njohjes së tij me materialet e çështjes në përfundim të hetimeve (nenet 75 dhe 102 të Kodit të Procedurës Penale), të cilat kyhen nga prokurori.

Neni 15

I pandehuri ose mbrojtësi i tij kanë të drejtë të ankohen në gjykatën e shkallës së parë kundër masës së arrestit të miratuar nga prokurori.

Ankesa shqyrtohet në seancë gjyqësore brenda 7 ditëve, në praninë e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Neni 16

Hetuesia organizohet pranë prokurorive të rretheve, prokurorive ushtarake dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Hetuesit emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 17

Mund të punojnë si gjyqtarë, prokurorë personat që kanë shtetësi shqiptare, janë diplomuar si juristë, gëzojnë të drejta të plota dhe kanë figurë të pastër morale.

Hetues mund të punojnë ata persona që kanë arsim të lartë si rregull juridik.

Neni 18

Funksioni i gjyqtarit, prokurorit dhe hetuesit është i papajtueshëm me ushtrimin e çdo mandati zgjedhor, të çdo funksioni publik e privat që sjell fitime, si dhe me ato detyra, të cilat i ndalohen shprehimisht me ligj.

Neni 19

Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit largohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur kryejnë një vepër penale, bëhen të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitojnë provimin periodik profesional, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, si dhe për cënim të figurës morale.

Neni 20

Për shkelje të disiplinës në punë ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, merren këto masa:

1- Vërejtje

2- Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra.

3- Pezullim nga puna deri në gjashtë muaj.

4- Transferim.

5- Largim nga detyra.

Masat disiplinore të parashikuara nga pikat 3, 4, 5 të këtij neni jepen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 21

Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar. Ata mund të ndalohen pa këtë pëlqim vetëm në rastet kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë.

Neni 22

Për çështjet që janë në hetim dhe gjykim si dhe për ato të ardhura e të pashqyrtuara nga gjykata, zbatohen dispozitat ligjore para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Dekreti nr.7174, datë 20.11.19897 "Për organizimin gjyqësor të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë", ligji nr.6298, datë 27.3.1981 "Për Prokurorinë e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë", ligji nr.6880, datë 29.6.1993 "Për hetuesinë e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë", me gjithë ndryshimet e tyre të mëvonshme si dhe të gjitha dispozitat e tjera që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.243, datë 7.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.